

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË

FAKULTETI I MJKËSISË DENTARE

**VLERESIM KONFOKAL I PENETRIMIT TË PASTES
BIOQERAMIKE (MTA FILLAPEX) NE TUBUJT
DENTINARE NE KANALET E PREPARUARA ME
LIMAT ME VETPERSHTATJE (SAF SYSTEM)**

DISERTACION PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

DOKTOR

UDHËHQËS SHKENCOR

PROF.DR.RUZDHIE QAFMOLLA

KANDIDATI

DR.ASTRIT KUÇI

**Familjes sime-bashkëshortes Atifetes,babait Dr.Xhavid dhe nipave të dashur,
Aron dhe Erik – stimuluesve më të lartë në jetën time.**

Falënderimet:

Prof. dr. RUZHDIE QAFMOLLA, Stomatologe dhe pedagoge e shkëlqyer në trojet shqiptare dhe më gjërë-mentore e këtij punimi, e falënderoj sinqerisht për punën e palodhshme, këshillat, sugjerimet dhe vërejtjet që i ka bërë gjatë punës sime.

Po ashtu falënderoj **Prof.Dr. TAYUN ALAÇAM** Ko-mentorin i punimit Profesor ne Fakultetin e Stomatologjis GAZI-ANKARA TURQI për ndihmën e dhënë me këshilla dhe sugjerime gjatë punës së doktoratës.

Falënderoj shumë kolektivin e **klinkes se Endodoncionit ne Fakultetin e Stomatologjis GAZI ANKARA-TURQI** që më dolën në ndihmë në çdo kohë.

Falenderim te posaqem **Z.Zeynep** prane Institutit UNAM-Bilkant Universitet Ankara-Turqi

Falënderoj shumë **Ass.DR Salih Krasniqin DR.Sci kirurg-laparoskopist**, i cili më ndihmoi në pjesën teknike kompjuterike të doktoratit si dhe **dr. Destan Kryeziu..**

Një falënderim shkon edhe për të gjithë ata të cilët në mënyra të ndryshme më ndihmuan në përgatitjen e temës së doktoratës.

I.PËRMBAJTJA

I.PËRMBAJTJA	4
II. HYRJE.....	6
II.1. Hapat kryesore të terapisë endodontike.....	6
II.2. Struktura e tubujve dentinare.....	7
II.3. Penetrimi bakterial në tubujt dentinarë.....	8
II.4. Efektet e përpunimit mekanik në sipërfaqet e kanaleve të rrënjeve.....	9
II.4.1. Objektivat biologjike të përpunimit mekanik janë:.....	9
II.5 Sistemi SAF (ReDent-Nova Ltd., Raanana 4300, Israel).....	10
II.5.1 Vecoritë kryesore të këtij sistemi.....	10
II.6 IRIGIMI I SISTEMIT TË KANALIT TË RRËNJËS.....	13
II.7 Ndikimi i smear layer në penetrimin dentinar të pastave të kanalit.	14
II.8 Efekti i llojeve të ndryshme të pastave në depërtimin në tubujt dentinarë	15
II.9 Pastat mbushëse me MTA.....	16
II.10 Efektet e teknikës së obturimit në penetrimin e pastës në tubujt dentinarë.....	17
II.11 Metoda për vlerësimin e penetrit të pastës në tubujt dentinarë.....	18
II.12 Mikroskopia konfokale me lazer.....	18
II. HIPOTEZA.....	19
III. QËLLIMI I STUDIMIT.....	20
IV. OBJEKTIVAT E STUDIMIT.....	20
V. MATERIALI DHE METODIKA.....	20
V.1 PËRSHKIMI I PROCEDURAVE ORIGJINALE TË PREPARIMIT MOSTRAVE	20
V.1.1 PROCEDURA E PREGADITJES SË MOSTRAVE PARA LEXIMIT NE MIKROSKOPIN KONFOKAL LASERIK.....	23

V.2 PËRSHKRIMI NË MËNYRE GRAFIKE I MATERIALEVE DHE METODIKËS.....	25
TABELA E GRUPEVE.....	26
VI. REZULTATET.....	29
VII.DISKUTIM.....	119
VIII.KONKLUZIONET.....	124
IX.REKOMANDIMET.....	125
X. LITERATURA.....	125

II. Hyrje

Terapia endodontike është një sekuencë trajtimi të pulpës së një dhëmbi që rezulton në eleminimin e infekzionit dhe mbrojtjen e dhëmbit të dekontaminuar nga infeksione të mëtejshme bakteriale.

II.1. Hapat kryesore të terapisë endodontike janë

- pastrimi,
- perpunimi,
- mbushja e kanalit.

Teknikat e preparimit dhe të mbushjes së kanalit janë shumë të rëndësishme për suksesin përfundimtar të trajtimit endodontik.

Arti i endodontise ka përparuar me teknologji të reja që ofrojnë rezultate më të mira dhe është automatizuar duke u bërë më efektiv falë avancimeve të metodave të automatizuara të përpunimit të kanaleve si dhe atyre të mbushjes.

Instrumentat rotator të Ni-Ti kanë shënuar një hap përpara në terapinë endodontike.

Megjithatë për të kapërcyer të metat e këtyre instrumentave, si psh: (forma ovale e papërshtatshme e kanalit , ndryshimi I formës origjinale, transportimi I mbeturinave, zhvendosje e apeksit origjinal,bërrylin, pragjet etj) është krijuar një sistem I ri për përpunimin e kanalit me instrumenta me vëtpershtatje. (Huslmann et al 2005)-¹

Ky sistem I ri për përpunim mekanik e kimik I pershatet formës tre dimensionale të kanalit të rrënës dhe largon dentinë nga muret e tij në mënyrë uniforme. Ai mund të parandalojë transportimin e mbeturinave për shkak të mungesës së një boshti rigid metalik dhe në sajë të irrigimit të vazhdueshëm(Metzger, 2010- ²; Özer, 2011)³.

Mbushja e kanalit pas preparimit me SAF mund të bëhet me cdo lloj metode të zakonshme të njohur për këtë proces. Pretendohet që mbushja e kanalit përshtatet mirë me muret e tij edhe në rastet e kanaleve te sheshta për shkak të pastrimit të plotë edhe të zonave më të vështira me këtë sistem. (Metzger, 2010)-⁴.

Pastat bioqeramike janë materiale të reja të propozuara për mbushjen e hapësirave endodontike dhe është provuar që pastat me permbajtje MTA shfaqin karakteristika ngjitëse me dentinen e kanaleve më të mira sesa pastat me përmbajtje ZnOE dhe kjo vecori ngjitëse është e ngjashme me pastat rezinoze. Ato paraqesin rrjedhshmëri dhe trashësi të pranueshme me standardet ISO (Kuga et al 2011) ⁵.

Me përparësi paraqitet përputhja dhe penetrimi i mbushësit në tubujt dentinare.

II.2. Struktura e tubujve dentinare

Dentina është një strukturë biologjike poroze e ndërtuar nga kristale apatite në një matriks kolagjeni. Kjo matriksë e mineralizuar zhvillohet nga odontoblastet që sëkretojnë kolagjen në nivel të bashkimit smalt-dentinë dhe pastaj rritet në mënyrë centripetale duke mbështjellë proceset e odontoblasteve (Pulpa e Dhëmbit).

Procedurat e trajtimit do të alterojnë sipërfaqen në mënyra që varen nga anatomia e kanalit, instrumentat e përdorur, strategjia dhe mënyra e përdorimit të tyre, si edhe irrigantet e përdorur për përpunim kimik.

Cdo tubul dentinare është një kon me dimensionin më të vogël nga ana e lidhjes smalt-cement dhe anën tjetër për nga pulpa. Cdo tubul ka një diametër prej 3 mikrometra. Në brendësi të cdo tubuli ka dentinë të varfër në fibra kolagjeni e hiperminalizuar që quhet dentinë intertubulare. Formimi i saj ngushton lumenin e tubulit nga 3 deri në 0.6-0.8 mikrometra në dentinën sipërfaqësore.

Numri i tubujve për millimetër kator varion nga 15.000 në bashkimin smalt-dentinë deri në 65.000 në afersi të pulpës. Ka më tepër tubuj për mm² në dentinën e thellë pranë kanaleve sesa në dentinën periferike. Struktura tubulare e dentinës krijon kanale për kalimin e solucioneve të ndryshme dhe mbushësve përmes dentinës.

Tek premolarët densiteti i tubujve në murin pulpar në nivel të lidhjes smalt-cement është më i madh në anën linguale sesa në anën mesiale dhe distale (72000 vs 42000 tubuj/mm²).

Dentina mund te konsiderohet njëkohësisht si barrierë dhe si strukturë e përshkueshme, në varësi të trashësisë së saj, moshës si dhe variablave të tjera (Pashley, D: Pulpodentin Complex, 63-93, in Hargreaves, KM, Goodis, HE: Seltzer and Bender's Dental Pulp. Quintessence Publishing Co, Inc, Chicago, 3rd Ed., 2002)⁶. Raporti i materialeve ekzogjene përgjatë dentinës varet nga kalueshmëria, përcjellshmëria hidraulike dhe diametri i tubulit (Pashley, DH: dentin permeability: Theory and practice. In: Spangberg, L (ed): Experimental Endodontics. Boca Raton, FL: CRC Pres, 1990:19-49. Pashley, DH: Clinical correlations of dentin structure and function. J Prosthet Dent, 1991; 66:777-781. Pashley, DH: Dentin-predintin complex: Physiological overview. J Dent Res, 1985;64(special issue):613-620)⁷. Prezenca, densiteti dhe diametri i tubujve variojnë me nivelin koronoapikal dhe moshën.

Tubujt dentinarë nuk janë tubuj të lëmuar por përbajnjë një sasi të konsiderueshme materiali intratubularë si noduj të mineralizuar dhe fibrile kolagjeni. Gjatë instrumentimit endodontik të kanalit të rrënjos largohet dentina e brendshme më e zbutur. Rritja në diametër e kanalit të

rrënjes con në një ulje të numrit të tubujve për mm². Përpunimi i kanalit krijon gjithashtu një shtresë smear layer në sipërfaqen e përpunuar.

Densiteti i tubujve është shumë më i vogël në dentinën apiakale se në atë koronare, dhe densiteti i tubujve apikalë mund të reduktohet edhe më tej me moshën, duke u bërë pothuajse translucente me kohën për shkak të depozitimit të shtuar të kristaleve minerale.

II.3. Penetrimi bakterial në tubujt dentinarë

Kanalet e ekspozuara ndaj kariesit janë të mbuluara njëtrajtësisht me pllakë bakteriale. Vëzhgime me mikroskop të dhëmbëve të kariuar sygjerojnë që shumica e flores në 5mm apikale të kanalit të rrënjes qëndrojnë pezull në një lumen të lagësht. Më rrallë vihen re aggregate dense të qelizave bakteriale të zhytura në matriks ekstracelulare, ngjitur në muret e dentinës së kanaleve.

Ndonjëherë gjenden grumbullime shumë-shtresore bakteriesh me morfotipe të ndryshme bakteriale. Format filamentoze zakonisht aderojnë perpendikulare me muret e dentinës, me kokët që radhiten në vargje në të njëjtin drejtim ose që aderojnë me filamentet. Biofilm bakterial konsiderohet më i vështirë për tu eleminuar se ato që rriten në suspension e fluide, si psh fenotipet planktonike.

Bakteriet që penetrojnë dentinë dominohen nga shkopinjtë (68%) dhe koket (27%) gram positive. Tipet predominuese janë laktobacilet (30%), streptokoku (13%) dhe propionobakterium (9%). Prania e bakterieve gram negative është konfirmuar indirekt nga detektimi i përqëndrimeve të larta të lipopolisaharideve në shtresat primare deri në thellësi 300 mikrometra.

Megjithëse variacionet në permeabilitetin e tubujve dentinarë mund të limitojnë penetrimin në vende të vecanta dento-anatomike, janë vërejtur variacione në modelet e invadimit mikrobial në drejtim apiko koronar (Love, 2002)⁸.

Në vijueshmëri me këto gjetje është fakti që aty ku tubujt janë të kalueshëm një pastë mbushëse me rrjedhshmeri të mjaftueshme dhe vecori lagëse e ngjitëse të mira duhet të penetroje të cementojë e të vulosë ato pak mikroorganizma të mbijetuar pas instrumentimit(Sjögren et al, 1997-⁹.

Lagështia, temperatura dhe përbajtja e tubujve dentinarë mund të ndërhyjë me kapacitetin e penetrimit të mbushësit në indin dentinal(Vassiliadis et al, 1994-¹⁰.

II.4. Efektet e përpunimit mekanik në sipërfaqet e kanaleve të rrënjosjeve.

Përpunimi mekanik është një etapë shumë e rëndësishme e terapisë endodontike pasi krijon hapësirën për depërtimin e irriganteve dhe medikamenteve të tjera kanalare që do të bëjnë rrënjosjen e baktereve dhe produkteve të tyre. Megjithatë mbetet një nga punët më të vështira në endodonti. Megjithëse ka shumë raportime në literaturë për përpunimin mekanik të kanalit, ende nuk ka evidenca shkencore përfundimtare mbi cilësinë dhe vlerën klinike të metodave të ndryshme të instrumentimit.

Përpunimi mekanik duhet të largojë të gjitha mbeturinat nekrotike dhe indet vitale nga kanali i rrënjosës, të ruajë integritetin dhe anatominë e kanalit, të shmangë dëmet jatrogjene, të lehtësojë mbushjen e kanalit, të shmangë irritime të mëtejshme dhe infeksione të indit periapikal dhe të ruajë dentinë të shëndetshme rrënje për të shtuar jetëgjatësinë e dhëmbit.

Teknikat e përpunimit mekanik të kanalit përfshijnë ato manuale, rotatore Ni-Ti, sonike dhe ultrasonike.

II.4.1. Objektivat biologjike të përpunimit mekanik janë:

1. kufizimi i instrumentimit brenda rrënjosës
2. moskalimi i mbeturinave nekrotike përtej foramenit
3. largimi i të gjithë mbeturinave indore nga kanali
4. krijimi i hapësirës së nevojshme për medikamentet intrakanalare.

Gjatë kësaj faze të punës mund të bëhen një sërë gabimesh jatrogjenike si shkallë, përforcime, devijim i drejtimit origjinal të kanalit, dëmtime të apeksit si dhe thyerje të instrumentave. Kur analizohet cilësia e përpunimit të kanalit vlerësohen disa parametra të konsideruar të rëndësishëm ndër të cilat cilësitetë pastruese dhe formëzuese të instrumentave si dhe siguria e tyre. Forma përfundimtare e kanalit të përpunuar do të varet nga forma e instrumentit dhe mënyra e përdorimit të tij. Në rastet e kanaleve të infektuara shumica e biofilmit bakterial eleminohet me instrumentim, megjithatë disa baktere mund të mbeten të rrënjosura në muret e dentines. Sipërfaqet e painstrumentuara duhet të konsiderohen si të kontaminuara.

Zgjatimet linguale dhe bukale në kanalet e crregullt janë nga zonat që paraqesin vështirësi në instrumentim. Përpunimi total vetëm me metoden manuale përmban një risk të lartë për përforcim si dhe dobëson ndjesheëm rrënjen. Nga ana tjetër mbetet e dyshimtë nëse instrumentat fleksibel Ni-Ti ofrojnë kontroll dhe përpunim të plotë të këtyre zonave. Lëvizjet rotatore të këtyre instrumentave i japin formë rrethore kanalit të rrënjosës pas përpunimit, duke lënë të pa përpunuar këto zgjatime linguale e bukale. Megjithatë lëvizje specifike përpunimi si fshirëse rekandohen të aplikohen me këto lloj instrumentash.

Përpunimi mekanik e lë kanalin e rrënjeës të mbuluar me smear layer nëse nuk ndiqet nga irrigimi me solucionet e duhura. Për shkak të eficiencies së ulët të irrigimit në receset anatomike, smear layer mund të grumbullohet dhe të mbetet në këto mure të kanalit duke ulur cilësinë e mbushjes dhe duke rrezikuar rezultatin afatgjatë të trajtimit.

II.5 Sistemi SAF (ReDent-Nova Ltd., Raanana 4300, Israel)

SAF është një sistem përpunimi biomekanik që funksionon në tre drejtime:

- pastrim,
- modelim,
- irrigim.

Sistemi SAF është i përbërë nga këto tre komponente- lima SAF e krijuar për tu përshtatur për mikromotor (RDT 3 dhe RDT3 NX) e cila krijon lëvizje të përsëritura si dhe sistemi i irrigimit VATEA që mundëson irrigimin.

II.5.1 Vecoritë kryesore të këtij sistemi

SAF është system preparues biomekanik i cili operon mbi principin e përbashkët funksional kombinim i lëvizjeve vibruese-rrotulluese dhe adaptimit tre dimensional në kanal duke bërë pastrimin, formësimin dhe irigimin. (Cohen, S, Levin, MD, Berman, LH: The SAF endo system:adaptive 3-D cleaning, shaping and disinfection. Cont Educ, 4(2):34-38, 2011-¹¹.

Sistemi SAF përbëhet nga tre komponentë kryesorë: Lima SAF, e krijuar për mikromotor (RDT3 dhe RDT3-NX) që krijon lëvizje të përsëritura dhe sistemi i irrigimit VATEA.

Karakteristikat kryesore të sistemit janë lëvizjet vibruese-rrotulluese, shumë të rëndësishme për të depërtuar në zona të vështira të kanalit.

Lima SAF është ndërtuar në formë të një cilindri me majë me mure të holla, për t'i dhëne më tepër veti elastike në kompozesim dhe është e përbërë prej rrjet teli nga nikel titaniumt (figura 1). Kjo është e disponueshme në 3 gjatësi të ndryshme: 21mm, 25mm dhe 31mm, dhe dy diametra: 1.5 dhe 2mm.

Instrumenti përbëhet nga bishti që lidhet direkt me kokën, pastaj vjen irriguesi i lidhur me pompën e irrigimit VATEA, pastaj boshti dhe pjesa më e rëndësishme, rrjeta e shufrave, që është pjesa punuese e sistemit.



Figura 1 SAF Gjilpëra

Një limë SAF me gjatësi 21mm ka 5mm bishtin dhe 16mm pjesën punuese, ndërsa lima 25mm ka bisht 7mm dhe 18mm pjesë punuese. Instrumenti 31mm ka bishtin 10mm dhe pjesën punuese 21mm.

Instrumenti SAF për shkak të formës së tij dhe sipërfaqeve abrasive realizon një zgjerim gradual të kanalit të rrënjos. Eshtë shumë fleksible dhe e komprimueshme. Nuk ia imponon formën e saj kanalit, por përshtatet me formën e tij origjinale. Kjo është e vlefshme në dy drejtime, si qarkore dhe gjatësore. Aksi i gjatë i kanalit ruhet.

Në sajë të veticë abrasive, presionit dhe lëvizjeve të përseritura, ky instrument përdoret për dhënien formë kanalit, pastrimin dhe irrigimin. Sipërfaqja e instrumentit është abrasive si letër gërryese me ashpërsi 2.8 mikrometra +/- 10%.

Për shkak të formës së saj, lima SAF mund të komprimohet në mënyrë elastike gjatë prerjes tërthore, kur futet në kanal të katerizuar më parë me instrument K nr.20. Për shkak të veticë elastike, instrumenti gjatë përpunimit ka tendencë të rimarrë formën e vet origjinale. Gjatë zgjerimit që i bën kanalit, instrumenti ushtron presion të lehtë të vazhdueshëm gjatë lëvizjeve të tij, gjë që krijohet nga vibrimi vertikale të vogla prej 0.4mm dhe 5000 goditje për minutë. Duke qënë se instrumenti është i lidhur me sistemin e pompës së ujit VATEA ai bën përpunim, pastrim dhe irrigim në të njëjtën kohë (Fihura 2).



Figura 2 Gypi I lidhur për limën SAF dhe sistemin irigues VATEA

Cka është më e rëndësishme për shkak të formës specifike të instrumentit, rrjeta e shufrave në vvetve gjatë irrigimit nuk bën transportim të mbetjeve indore apo likideve te irrigimit përtej apeksit.

Sistemi i irrigimit VATEA përbëhet nga pompa e brendshme ku mund të përcaktohet paraprakisht sasia e ujit që duam të përdorim për irrigim nga 1ml/min-10ml/min.

Pompa e ujit e integruar është krijuar e tillë që të krijojë më pak presion se shiringat që përdoren zakonisht për irrigim manual.

Presioni i krijuar nga VATEA është shumë më i padëmshëm se ai i krijuar nga irrigimi me shiringa.

Sistemi mund të funksionojë me energji elektrike ose dhe me bateri te rikarikueshme me kohë pune deri ne 4 orë.

Në panel ka një ekran LCD ku tregohet niveli i baterisë, shpejtësia e rrjedhjes së irrigantit, si dhe butonat që kontrollojnë këtë funksion. Në pjeseën e poshtme të pajisjes është dalja e ujit dhe dalja e pedalit të këmbës, ndërsa në pjesën e pasme gjendet rezervuari me kapacitet 400ml, dalja e karikuesit elektrik, si dhe butoni i ndezje/fikjes(Figura 3).



Figura 3 Sistemi irigues VATEA

Ka dy lloje te ndryshme kokash RDT3 dhe RDT3-NX.

1. RDT3 është kompatibël me X-smart/endomate ku paraprakisht duhet të përdorim adaptuesin e duhur.
2. Koka e dyle është RDT3-NX që është kompatibël me NSK dhe mund të përdoret me kontranglin me shpejtësi te ulët, në këtë rast duhet të përdorim takometrin për të përshtatur xhirot e duhura rpm për një motor me ajër.

II.6 IRIGIMI I SISTEMIT TË KANALIT TË RRËNJËS

Sfida për një trajtim endodontik të suksesshëm ka qenë gjithmonë largimi i mbeturinave indore vitale e nekrotike, mbeturinave të krijuara gjatë punës, smear layer, mikroorganizmave dhe mikrotoksinave nga sistemi i kanaleve. Edhe me përdorimin e instrumentave rotator, instrumentat Ni-Ti veprojnë vetëm në pjesën qëndrore të kanalit të rrënjos, duke rezultuar në mangësi në irrigim. Vec kësaj enterokoku fekal dhe actinomyces Israeli (të dyja specie të gjendura në rastet e infeksioneve endodontike, si dhe në rastet me dështim trajtimit), penetrojnë thellë në tubujt dentinarë, duke e bërë largimin e tyre me anë të instrumentimit të pamundur. Dhe së fundi, E. feacalis paraqet rezistencë edhe ndaj disa lloj medikamentesh, duke e komplikuar më tej trajtimin. Nisur nga kjo, nevojitet një sistem i përshtatshëm irrigimi për suksesin e terapisë endodontike. Solucionet irrigues duhet të janë jo vetëm eficente në shkrirjen e mbeturinave indore, por duhet edhe ësse eleminojnë kontaminimin bakterial dhe të largojnë smear layer.

Këto veti të dëshiruara të irrigantit përfshijnë edhe aftësinë për të shkrirë inde nekrotike dhe indin pulpar, të bëjnë dekontaminim dhe të kenë spekter të gjerë antimikrobial, aftësine për të depërtuar thellë në tubujt dentinarë, të janë biokompatibël, të mos janë toksike, të përdoren lehtë e të kenë kosto të ulet.

Solucioni më i përdorur për këtë qëllim është hipokloriti I natriumit, EDTA dhe klorheksidina.

Irriganti që plotëson shumicën e kërkesave të sipërpërmendura është NaOCl. Ai ka veti të vecantë të bëjë shkrirjen e mbeturinave indore dhe komponentin organik të smear layer. Ai gjithashtu eleminon patogenenë endodontikë të organizuar në biofilm. Megjithëse NaOCl duket më i parapëlqyeri, ai nuk mund të tresë përbërësin inorganik të dentinës dhe kështu nuk mund të parandalojë formimin e një smear layer gjatë instrumentimit.

Agjentë demineralizues si EDTA janë rekomanduar si ndihmës në terapinë endodontike. Për këtë arsyе në endodontinë kontemporane, përdoren shpesh irrigantë të dyfishtë si NaOCl dhe EDTA si irrigantë fillestare dhe përfundimtare për të kapërcyer mangësitë e gjithsecilit. Këto solucione duhet të kenë kontakt direkt me muret e dentinës për të ofruar një veprim efektiv, sidomos për pjesën apikale të kanalit.

Përqëndrimi I NaOCl që përdoret për irrigim varion nga 2.5% deri në 6%, megjithatë hidroliza indore është më efikase në përqendrimet e mëdha brenda këtij intervali. Këto përqëndrime të larta mund të veprojnë mirë edhe ndaj mikrobeve. EDTA është agjent kelant që vepron mirë në largimin e smear layer dhe rrit permeabilitetin e dentinës, gjë që do të lejojë irrigim të mëtejshëm me NaOCl për të depërtuar thellë në tubujt dentinarë.

Dy faktorë të rëndësishëm që duhen marrë në konsideratë gjatë procesit të irrigimit janë aftësia e sistemit për të shpërndarë solucionin në të gjithë kanalin, vecanërisht në të tretën apikale dhe aftësia e irrigantit për të pastruar zona që nuk mund të arrihen me anë të instrumentimit mekanik, si thellë në tubujt dentinarë, në kanale laterale dhe ne istmuse.

Pompa peristaltike VATEA hedh në qarkullim një sasi të vazdueshme irriganti që hyn në kanal përgjatë gjithë gjatësisë së instrumentit. Për shkak të formës së instrumentit në kanal nuk krijohet stres gjatë punës. Lëvizja e instrumentit bën të mundur disa vibrime që lejojnë depërtimin e irrigantit në pjesën apikale të kanalit me aktivizim sonik.

II.7 Ndikimi i smear layer në penetrimin dentinar të pastave të kanalit.

Smear layer është kthyer në një faktor të rëndësishëm endodontic me publikimin e McComb dhe Smith (1975)- ¹². Ata raportuan që kjo ishte një shtresë materiali që mbulonte muret e kanalit të preparuar dhe bllokonte tubujt dentinarë.

Smear shtresa që krijohej gjatë përpunimit mekanik në sipërfaqe të dentinës u vu re se inhibonte penetrimin e pastave në tubujt dentinarë. Vec kësaj ajo formon një sipërfaqe të padëshirueshme mes pastës mbushëse dhe dentinës së kanalit. Kjo mund të ketë domethënje klinike në lidhje me retentionin e materialeve mbushëse të kanalit, parandalimin e mikrorrjedhjeve përgjatë sipërfaqes në-dentinë dhe aktivitetin antibakterial të pastave të ndryshme kanalare. Gjithashtu smear layer mund të përmbaje edhe mbetje indi nekrotik e bakteriesh ne vetvete.

Vitet e fundit janë studiuar një sërë aspektesh në lidhje me smear layer si fuqia demineralizuese e agjentëve kelantë(DeDeus et al, 2006- ¹³, sol EDTA(DeDeus et al, 2006- ¹⁴; , ndikimi i irrigimit ultrasonik(Alaçam, 1987)- ¹⁵, lloji i smear layer të formuar nga instrumenta të ndryshëm endodontikë dhe volumi i solucionit të përdorur(Yamada et al, 1983- ¹⁶, lidhja e kelateve me klorheksidinen dhe NaOCl, aktiviteti antibakterial dhe kryesish lidhja kohe-eficencë për të larguar plotësisht smear layer pa dëmtuar matriksin dentinarë(Goldberg and Spielberg, 1982-¹⁷; Barkhordar et al, 1997 ¹⁸.

Janë hartuar një sërë metodash dhe materialesh për largimin e smear layer gjatë terapisë endodontike. Ato përfshijnë përdorimin e NaOCl , EDTA, acide organike si ac.citrik, laktik, maleik dhe përfshirjen e ultrasonikeve dhe lazerit. Metoda më e përhapur dhe më efektive ka qënë përdorimi i EDTA e ndjekur nga NaOCl. EDTA largon indin e kalcifikuar, ndërsa NaOCl shkrin mbeturinat organike.

Eshtë vënë re që EDTA 17% dhe NaOCl 5.25% janë efektive në largimin e smear layer. Kjo e lejon pastën të depërtoje më mireë në tubujt dentinarë. Pas kesaj, penetrimi në tubuj do te rrisë adezionin midis dentinës dhe pastës. Megjithatë zona më kritike është regjioni apikal ku është e vështirë të largohet smear layer. Eshtë e rëndësishme të kuptohet që prania vetëm e materialeve dentare (psh pastë apo gutaperka) nuk është e mjaftueshme për një vulosje perfekte.

Eshtë pohuar që largimi i smear layer mund të përmiresojë mbushjen me gutaperka dhe pastë si dhe kondensimin lateral (Kennedy et al 1986) ¹⁹. White et al (1984)- ²⁰ raportuan që dy materiale mbushëse plastike munden të depërtonin në tubujt dentinarë pas largimit të smear layer. Oksan et al (1993)- ²¹ bllokonte penetrimin e tubujve nga pasta dhe doli në përfundimin se ky penetrim mund të ndikohej nga veti fizike e kimike të materialit mbushës të kanaleve. Megjithatë Vassiliadis et al (1994)- ²² gjetën se smear layer nuk i pengon pastat të depërtojne në brendësi të tubujve dentinarë.

II.8 Efekti i llojeve të ndryshme të pastave në depërtimin në tubujt dentinarë

Depërtimi i pastave mbushëse nëpër tubujt dentinarë është konsideruar si efekt i dëshiruar i trajtimit. Duke pasur si qëllim një cilësi më të mirë të adaptimit të mbushjes në muret e dentinës së kanalit, pastat janë përdorur si përforcues të mbushjes. Përdorimi i pastës përmirëson cilësinë e mbushjes së kanalit. Pastat janë të nevojshme për të mbushur hapësirat midis koneve të gutaperkes dhe mureve të kanalit. Ato mbushin gjithashtu kanalet laterale dhe hapësirat e parregullsiteë në kanal. (Johnson et al, 2006)- ²³. Pastat mund të depërtojnë shpesh në tubujt dentinarë, gjë që rrit sipërfaqen e kontaktit midis mureve të dentinës dhe materialit mbushës dhe mund të përmiresojë retentionin mekanik të mbushjes ëe rrënjës. (White et al,

1987)-²⁴. Vec kësaje pastat mund të izolojnë në kanal cdo mbetje bakteresh dhe irritantet e tyre dhe të parandalojë rikolonizimin dhe riinfektimin(Weis et al, 2004)-²⁵.

Aftësia e pastave të mbushjes së kanalit per të penetruar në tubujt dentinarë vlerësohet si një aspekt i rëndësishëm në parandalimin e riinfektimit të kanalit. (Weis et al, 2004)-²⁶.

Përvec teknikës së mbushjes, një tjetër faktor që ndikon në penetrimin e pastës është diametri i tubujve dentinare dhe lloji i pastës, vetitë fizike e kimike të pastës, tensioni sipërfaqësor, plasticiteti, stabiliteti dimensional, dhe diametri i pjesëzave përbërëse (Balguerie et al, 2007-²⁷; Oksan et al, 1993)-²⁸. Lagia e sipërfaqes varet nga përbërja kimike e sipërfaqes së ngurtë, ashpërsia dhe niveli i hidratimit. Ulja e tensionit sipërfaqësore të një irriganti do të përmiresojë depërtimin e tij në tubujt dentinarë.

Pastat mund të grupohen sipas përbajtjes së tyre si, ZnOE, Hidroksidd Kalciumi, rezinoze, glassionomer, jodoform, silicone dhe bioqeramika (calcium silikat dhe me permajte MTA).

Aftësia e pastës për të depërtuar tubujt dentinarë është një nga vetitë më të rëndësishme të saj ku bazohet edhe zgjedhja e pastës për mbushje kanali(Mamootil and Messer, 2007-²⁹).

II.9 Pastat mbushëse me MTA

Vetitë fizike të MTA pas përzirjes e bëjnë të vështirë mbushjen e kanalit, pasi përzierja e MTA me uje të distiluar formon një masë kokrrizore (Cintra et al, 2007)-³⁰.

Sot ekzistojnë pasta endodontike me përbajtje MTA si Proroot Endosealer (Dentsply), MTA Fillapex(Odontologicas, Londrina, PR, Brazil), të cilat janë biokompatibel dhe stimulojnë mineralizimin (Gomes-Filho et al, 2009)-³¹. Ato shfaqin gjithashtu adezion më të lartë ndaj dentinës krahasuar pastat me bazë ZnOE (Huffman et al, 2009)-³² dhe veti izoluese të ngjashme me pastat me bazë epoksi (Weller et al, 2008)-³³.

Sipas prodhuesit përbërja e Fillapex pas përzierjes është MTA, rezinë salicilat, rezinë natyrale, bismuth dhe silic. Në mënyrë ideale materiali duhet të paraqesë një pH alkalin dhe të clirojë kalcium për të stimuluar mineralizimin e indeve (Estrela et al, 1995-³⁴; Holland et al 2001)-³⁵.

Materiali përbush të gjitha standardet e ISO 6876, përfshirë rrjedhshmërinë, kohën e punës dhe trashësinë e shtresës.

Kur u krahasua pH dhe clirimi i kalciumit midis Fillapex MTA me MTA të bardhë dhe gri, rezultoi që Fillapex shfaqte vlera pH më të ulta se të tjerat dhe clirim më të vogël kalciumi në një kohë vlerësimi pas 24 orësh dhe pas 7 ditësh.

Megjithatë të gjithë materialet ë krahasuara shfaqen pH alkalin dhe clirimi kalciumi në të gjitha periudhat kohore të vlerësuara. (Kuga et al, 2011)-³⁶.

Demiriz et al (2012)-³⁷ zbuluan me anë të testit të penetrimit të ngjyruesit që rrënjet e mbushura me Fillapex MTA + gutaperka kishin më pak rrjedhje se ato të mbushura me AH Plus dhe gutaperka.

II.10 Efektet e teknikës së obturimit në penetrimin e pastës në tubujt dentinarë

Qëllimi kryesorë i mbushjes së kanalit është parandalimi i shkëmbimeve midis kavitetit oral, sistemit të kanaleve të rrënjos dhe indeve periradikulare, duke krijuar një barrierë ndaj infektimit dhe riinfektimit të kanalit (Guttman and Witherspoon, 2002-³⁸; Weiss et al, 2004)-³⁹.

Afërsia midis guttaperkave dhe mureve të kanalit do të kufizonte kalimin e mikroorganizmave dhe nënprodukteve të tyre, përgjegjëse për sëmundjet periapikale (Kertsen and Moorer, 1989)-⁴⁰. Edhe pse pastat përmirësojnë vulosjen e kanalit duke mbushur cdo hapsirë të mbetur, (Hata et al, 1992)-⁴¹ dhe lidhjen me dentinën (Nayar et al, 2003)-⁴², rezultati optimal në mbushjen e kanalit do të ishte të maksimalizohej volumi i materialit bazë mbushës dhe të minimizojë sasinë e pastës midis bërthamës inerte dhe mureve të kanalit (Peters 1986-⁴³; Wu et al, 2004)-⁴⁴.

Faktoret të cilët kanë ndikim në kapacitetin e penetrimit të pastave endodontike në tubulat e dentinës sikurse janë- smear shtresa e cila I mbyll hyrjet e tubulave diametric I tubulave, aktiviteti sipërfaqesor I pastave, këndi kontaktues ndërmjet pastes dhe murit të dentinës dhe teknika e aplikuar e obturimit (DeDeus et al, 2004)-⁴⁵.

Teknika e obturimit si dhe vetitë fizike dhe kimike të pastës mbushëse do të përcaktojnë trashësinë e shtresës së pastës mbushëse (Eguchi et al, 1985-⁴⁶; Peters 1986)-⁴⁷. Teknikat e mbushjes varen shumë nga teknika e përpunimit të kanalit. Kjo ka çuar në zhvillimin e shumë sistemeve përpunim-mbushje të cilat mund t'i përshtateten më tepër një kanali të përpunuar në mënyrë uniformë dhe qëndrore. (Bal et al, 2001)-⁴⁸.

Evaluimi dhe krahasimi i teknikave të preparimit të sotëm, regjimenteve të irigimit dhe teknikave të obturimit në ndikimin e tyre relatin për arritjen e rezultateve optimale.

Weiss et al (2004)-⁴⁹ kanë zbuluar që trashësia e pastës varej ngushtësisht nga teknika e mbushjes. U vu re penetrim konsistent dhe ekstensiv i pastës në tubujt dentinarë dhe kjo e pa varur nga teknika e mbushjes. Bal et al, (2001)-⁵⁰ treguan që penetrimi i spreader deri ne 1mm mund te bëhet i tepërt nga një përputhje më e mirë e amster konit me kanale të përpunuara në mënyrë uniformë me të njejtin konicitet.

Eshtë dalë në përfundimin që largimi i smear layer mund të përmirësojë mbushjen me gutaperka, pastë dhe teknike kondensimi lateral (Kennedy et al, 1986)-⁵¹.

II.11 Metoda për vlerësimin e penetrimit të pastës në tubujt dentinarë

Materiali dhe metoda e lidhur me këtë mbështeten nga studime laboratorike në vend të kontrolleve klinike të randomizuara. Shumica e studimeve janë bërë duke përdorur SEM. Metoda të tjera të përdorura deri tani janë ato me SEM mjedis. Metodat tjera të përdorura deri më tani janë environmental scanning electron microscopy, field emission scanning electron microscopy (FESEM), transmission electron microscopy (TEM), atomic force microscopy, energy dispersive spectroscopy, atomic force microscopy and optical microscopy. Ndërsa kohve të fundit po përdoret Mikroskopia konfokale laserike.

II.12 Mikroskopia konfokale me lazer

Mikroskopia konfokale është një teknike imazherie optike e përdorur për të rritur rezolucionin dhe kontrastin e mikrografit duke përdorur iluminimin me pikë dhe një pikë spaciele për të eleminuar dritën jashtë fokusit në mostra më të trasha se plani fokal. (Pawley JB) 2006⁵². Kjo mundëson rindërtimin e strukturave tre dimensionale nga imazhet e përfshira. Një mikroskop konvencional sheh aq larg sa mund të penetrojë drita në mostër. Ndërsa një mikroskop konfokal shikon imazhet shtresë pas shtrese. Mikroskopet konfokale përdorin një cift pasqyrash për të skanuar lazerin përmes mostrës. Avantazhet e fluoreshencës në mikroskopi janë që mund të atashojmë molekula fluoreshente tek pjesë specifike të mostrës sonë në mënyrë që vetëm ato pjesë të shfaqen në mikroskop. Drita e lazerit reflektohet nga një pasqyrë dikroike. Nga aty lazeri godet dy pasqyra të cilat janë të montuara në motorë; këto pasqyra skanojnë lazerin përmes mostrës. Ngjyruesi në mostër duket fluoreshent dhe drita e emetuar shpërhapet nga të njejtat pasqyra që përdoren për të skanuar dritën e eksituar nga lazeri. Drita e emetuar kalon përmes dikrokës dhe fokusohet në një vrimë. Drita që kalon nëpër këtë vrimë matet nga një detektor. Kështu nuk kemi asnjëherë një imazh të plotë të mostrës, por në një moment të caktuar kemi vetëm imazhin e një pjesë të caktuar të mostrës. Detektori është i atashuar në një kompjuter që ndëronton imazhin, një piksel në njësi kohe. Në praktike kjo mund të bëhet 3 herë në sekondë, për një imazh 512x512 piksel.



Figura 4 mikroskopi konfokal laserik

Efekti praktik i kësaj është që imazhi vjen nga një seksion i hollë i mostrës. Duke skanuar shumë seksione të holla merret një imazh më i qartë tre dimensional. Mikroskopia konfokale është përdorur për të përfshiruar një sërë imazhesh optike që regjistrohen përmes trashësisë së dentinës. Krahasuar me mikroskopin elektronik dhe metodat histologjike. Mikroskopia konfokale ka avantazhin e sigurimit të një informacioni të detajuar mbi prezencen dhe shpërndarjen e pastave mbushëse brenda tubujve dentinarë në të gjithë diametrin e kanalit të rrënjos në një zmadhim $x10$ - $x63$ me anë të markuesve rhodamine fluoreshente (D'Alpino et al, 2006)-(61). Për rrjedhojë përqindja e adaptimit të pastave në kanalet e rrënjos mund të arrihet lehtësish me fotografi të mikroskopisë konfokale. Sekuencat imazherike merren në formë dixhitale dhe mund të procesohen nga programe që bëjnë analizën e imazheve për të kuantifikuar saktësisht karakteristikat (Paciornik and Mauricio, 2004)-⁵³.

Më tej mostra mund të hiqet nga mikroskopi dhe të ruhet per t'ju nënshtuar disa modifikimeve dhe kështu ndryshimet në moster mund të ndiqen në kohë për të njëjtin pozicionim, duke i dhëne eksperimentit natyrë longitudinale.

M.K siguron rezultate kuantitative të pavarura nga operatori. Procedura është e shpejte dhe e ripërsëritshme. (DeDeus et al, 2011)-⁵⁴.

II. HIPOTEZA

Nga ky punim pritet që adaptimi i përsosur në muret e kanalit dhe penetrimi më i thellë i pastave në tubulat e dentinës të konsiderohet të jetë potencialisht i mundshëm dhe i

realizueshëm pas trajtimit me metodat SAF sistem modern për preparimin e kanalit të rrënjosku pritet që dështimet endodontike të jenë fare të pakta ose të mos ketë fare.

III. QËLLIMI I STUDIMIT

Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi ex vivo i penetrimit të mbushësit bioqeramik (MTA Fillapex) në tubujt dentinarë në kanalet e rrënjosjeve të përpunuara me SAF System dhe të mbushura me gutaperka.

IV. OBJEKTIVAT E STUDIMIT

Objektivat e studimit janë vlerësimi dhe dokumentimi i penetrimit të pastes me anë të metodës së mikroskopit konfokal laserik, ku perfshihet imazhimi digital shumështresor i preparative me qëllim të përcaktimit sa më të saktë dhe në pamje të dukshme të penetrimit të pastes në tubulat e dentimës e me këtë edhe vlerësimi i aftësive pastruese të SAF sistemit në të gjitha anët, muret e kanaleve të rrënjosku.

V. MATERIALI DHE METODIKA

Depërtimi në tubujt dentinarë i një mbushësi bioqeramik me bazë MTA (MTA Fillapex; Odontologicas Londrina, PR, Brasil) në SAF (ReDent-Nova Ltd., Raanah 4300, Israel). Kanalet e preparuara u vlerësuan me anë të mikroskopisë konfokale për tezën e këtij studimi. Pas përpunimit dhe irrigimit me SAF me dy lloj irrigantësh të ndryshëm, penetrimi dentinar i pastave u gjurmua në rrënjet e mbushura dy lloje të ndryshme pastash dhe teknikash.

V.1 PËRSHKIMI I PROCEDURAVE ORIGJINALE TË PREPARIMIT MOSTRAVE

Për studimin u përdorën 45 dhëmbë premolarë monoradikularë të ekstraktuar. Pas ekstraksionit të gjithë dhëmbët u ruajtën në salinë. Kurora u pre në nivel të bashkimit smalt-cement me freza me shpejtësi të lartë dhe me ujë. Një limë K me nr 10(VDW GmbH, München, Germany) u fut në kanal të cdo dhëmbi deri sa arrinte apeksin anatomik. Gjatësia e punës u llogarit duke zbritur 1mm nga apeksi anatomik. Sigurohej një kateterizim paraprak duke përdorur instrumenta limë K 10-25(VDW GmbH, München, Germany). Instrumenti SAF punoi në cdo kanal per 4 min me irrigim të vazhdueshëm. Instrumenti u perdor i montuar në një kontrangel (RDT3-NX, ReDent Nova) me një amplitudë prej 0.4 mm dhe me 5,000 vibrime në minutë. Operatori vazhdimesht kryen lëvizje hyrëse dalëse në kanal. Gjatë 4 minutave të

preparimit është bërë edhe irrigim me NaOCl 2.6%. Irriganti sigurohej vazhdimesh nga pompa



VATEA e sistemit me një ritëm prej 5ml/min.

Pastaj 5 dhëmbë u zgjodhën si grup kontrolli pa bërë asnje aplikim tjetër. Më pas 20 kanale nga 40 u irriguan me 2ml EDTA 5% (Wizard, Turkey) per 3 minuta per të larguar smear layer. Në fund u përdor 1 ml NaOCl për shpëlarje.

Kanalet u thanë me paper point (DiaDent Group, South Korea). Rrënjet e irriguara me dhe pa EDTA u ndanë rastësisht në 4 nëngrupe me 5 rrënje secili dhe u mbushën si më poshtë: Gjysma u mbushën me MTA Fillapex(Odontologicas, Londrina, PR, Brasil) dhe tjerat me AH26(Dentsply, DeTrey, GmbH).



AH26 and MTA Fillapex pastat

Pastat u perzjenë sipas instruksioneve të prodhuesit. Proporcionet e sakta u përcaktuan duke përdorur një peshore analitike precize. Megjithatë MTA Fillapex u përzje duke marrë sasi të barabarta të pastave A dhe B nga 2mm. Për të lejuar analizën me mikroskopi konfokale, secila paste u markua me rhodamine B(Alfa Aesar gmbH: C₂₈H₃₁CN₂O₃) me përqëndrim afërsisht 0.1%. Pasta u aplikua me spreader manual nr 25(Dentsply Maillefer). Më tej këto rrënje u ndanë në 2 nëngrupe dhe grupi i parë u mbush me teknikën e kondensimit lateral me masterkon 25(DiaDent-Dentplus, South Korea) dhe duke e ngjeshur me finger spreader të futur në kanal deri në 2-3 mm nën gjatësinë e punes. U futën kone aksesore me konicitet 0.2 deri sa u mbush e gjithë hapësira.

Grupi i dytë i rrënjeve pas aplikimit të pastës, u vendos master koni dhe u fut në kanal një plugger i nxehte 5-6 mm nën gjatësine e punës për të hequr pjesën koronare të gutaperkës. Pjesa koronare e gutaperkes u kondensua duke përdorur finger plugger dhe pjesa tjeter e kanalit u mbush me injektim të gutaperkës së ngrohtë me sistemin Obtura II(Obtura Corporation, Fenton, UK), duke injektuar nga



2-3 mm dhe duke e kondensuar vazhdimesht. Dhëmbët, gutaperka e tepërt dhe ajo koronare u hoq me majën e nxehë të instrumentit të

System B, në thellësi 1 mm nga hyrja e kanalit. (Model 1005, Analytic Technology, Redmond,

WA, USA).



Pas caktivizimit të mbartësit të nxehësisë u krye kondensim vertikal me plugger dore për të kondensuar gutaperken në të tretën koronare. Kavitetet e aksesit u izoluan me glassionomer (Kavitan Plus, Spofa Dental, Czech Republic).

Pas mbushjes u bënë radiografi nga ana meziale e bukale për të vlerësuar vizualisht mbushjen.


Gjatë kësaj procedure dhëmbët u mbajtën në sishka të vogla dhe u ruajtën në ambient pa drithë. Më tej të gjithë mostrat u transferuan në inkubator në lagështi 100% në 37 gradë celcius për 48 orë. Më pas rrënjet u fiksuan në material rezine akrilike (Meliodent, Heraeus, Kulzer, GmbH, Germany) duke lënë të eksposuar vetëm apeksin. Çdo mostër u nda horizontalisht në distancë 4, 8 dhe 12 mm nga forameni apikal me disk diamanti në aparatin Mecatome T201A (Presi Tavernoles, France) me 500 rpm duke e irriguar vazhdimesh me ujë për të parandaluar mbi nxehjen.

V.1.1 PROCEDURA E PREGADITJES SË MOSTRAVE PARA LEXIMIT NE MIKROSKOPIN KONFOKAL LASERIK

Para se të fillonte eksperimenti me MKL, sipërfaqja e mostrave polirohet derisa perfitohet një sipërfaqe e sheshtë duke e shfrytzuar Mecapol P230 (Presi Tavernoles, France)në të cilin janë vendosur disqe me letër zmerile (P 1000).

Segmentet e dentinës janë egzaminuar me mikroskopin konfokal Carl Zeiss LSM 510 në UNAM (National Centre of Nanotechnology of Bilkent University, Ankara, Turkey) dhe matjet e thellsisë së depërtimit të pastes janë bërë për çdo treten e kanalit rrënjës nga 4 faqet e ndryshme (mezial, distal, bukal dhe lingual).

Mostrat e dentinës janë analizuar duke përdorur zmadhimin $x 10$ të lenteve zmadhuese vajore . X63lentet vajore gjithashtu janë përdorur për fushat përfundimtare të mostrave .Shtresa vizuale janë përzgjedhur $10 \mu\text{m}$ nën nivelin e sipërfaqes së mostrave .X9 Fotot e marra janë bërë me skanimin $88,34$ um të trashësisë së dentinës duke marr hap pas hapi shtresat $7,3$ um në formatin $1,024 \times 1,024$ pikselë.Imazhet janë mbledhur dhe analiza e thellsisë është bërë me anë të softverit ZEN 2011 .Thellsia e depërtimit të pastave është marrur,matur dhe regjistruar në 10 pikë të sipërfaqeve të ndryshme .Muri i kanalit ka shërbyer si pikë fillestare prej ku më tutje deri në depërtimin maksimal është bërë matja e pastes në tubulat e dentinës .



V.1.2 PROCEDURA E PËRCAKTIMIT TË CILËSISË SË DEPËRTIMIT TË PASTËS

Për të përcaktuar cilësinë e depërtimit të pastës në tubujt dentinarë, u morën në vlerësim 3 faktoret e kompletimit, vazhdueshmërisë dhe njëtrajtshmërise duke përdorur një sistem klasifikimi me pikë nga 0 deri në 3 që përcaktonin cilësinë nga më e mira tek më e keqja, sipas kritereve të Malyk et al (2010)⁵⁵.

Kompletimi (homogeniciteti i penetrimit të pastës në tubuj): 0=90-100%, 1- 50-90%, 2-10-50%, 3= 0-10%

Vazhdimesia (gjurmë të pandërprera të pastës në kanale): 0=90-100%, 1- 50-90%, 2-10-50%, 3= 0-10%

Njëtrajtshmëria (gjatësia e njëjtë e gjurmëve të pastës): 0=90-100% te gjurmëve të pastës ishin të njëjtë në gjatësi, 1- 50-90%, 2-10-50%, 3= 0-10%.

Të gjitha matjet të marra nga segmente të ndryshme të rrënës së përfundimtare, pastat dhe metodat e mbushjes dhe nivele të ndryshme u regjistruan dhe u përdor analiza statistikore jo parametrike e Kruskall-Wallis dhe Mann Whitney U, për të përcaktuar diferençat statistikore mes grupeve.

V.2 PËRSHKRIMI NË MËNYRE GRAFIKE I MATERIALEVE DHE METODIKËS

Grafiku i studimit






TABELA E GRUPEVE



MIKROTOMI-aparaturë për prerjen e mostrave




Billoqe speciale për formimin e bllokut nga Rezina



Billojet e Rezinës së bashku më rrënjen



1.blloku i rezinës në mikrotom 2.Aparatura për lustrimin e mostrave



1.Vendosja e mostrave në inkubator me ambient temperaturë të kontolluar2.Programi ZEN



1.mbulimi I mostrave me folie



2.preparatet e gatshme per MKL

VI. REZULTATET

I. Matjet e thellësisë së depërtimit

Mesataret aritmetike dhe Devijimi standard jepen në Figurën 18 (mμ).

Figure 18. Thellësitë e depërtimit në grupet e studiuara (n=50, X ± Sx)

Metoda e pastrimit	Metoda e mbushjes	Koronale (Cervikale)				Mediale				Apikale		
		M	D	B	P	M	D	B	P	M	D	B
I*	LC	218.00±122 .972	357.00±199 .013	617.90±77. 854	728.50±217 .425	261.20± 101.028	192.50±96. 003	596.50± 261706	838.90±237 .253	248.50±44. 281	127.00±57. 225	520.00±163 .918
	WGP	952.80±328 .534	793.82±427 .053	994.20±245 .698	922.80±341 .963	768.80± 327.767	791.40±397 .980	1124.70 ±411.42	1204.20±17 8.544	406.90±364 .837	463.44±264 .552	879.80±446 .133
II**	LC	422.92±117 ,443	399.80±147 ,917	558.40±176 ,350	544.10±240 ,341	462.18± 339.144	255.30±132 ,743	747.90± 393.203	1008±348,4 84	514, 16±189,956	303.60±197 ,606	353±238,48 9
	WGP	606.80±329 .820	798.20±411 .204	994.80±443 .903	1242.00±32 5.551	831.00± 388.121	550.92±322 .995	1203.00 ±183.00	1336.80±20 6.142	608.60±227 .408	527.00±407 .102	869.40±339 .420
I	LC	606.10±482 .579	455.50±451 .891	681.10±449 .037	843.00±532 .126	343.67± 272.672	434.50±307 .964	696.00± 253.598	742.50±295 .966	527.10±331 .387	434.18±270 .027	510.40±322 .914
	WGP	370.60±167 .276	327.50±195 .303	818.80±187 .253	482.40±125 .788	283.25± 128.030	244.00±129 .866	595.92± 110.717	546.50±78. 300	310.00±27. 889	309.00±64. 023	422.75±76. 961
II	LC	506.40±215 .917	447.40±98, 354	818.60±226 .536	722.22±263 .042	467.75± 313.961	422.83±188 .852	942.40± 129.450	887.20±221 .747	291.07±191 .642	377.33±141 .882	459.80±82, 721
	WGP	202.05±127 .545	168.60±117 .591	602.20±228 .100	607.70±227 .025	251.20± 149.977	170.17±125 .110	543.92± 123.335	491.80±158 .685	159.00±15. 239	100.50±67. 783	296.00±108 .552

* I : Derdhja NaOCl

** II : NaOCl + EDTA + NaOCl

III.Cilësia e depërtimit të mbyllësit të kanaleve në tubat dentinalë.

Gjetjet për vazhdueshmërinë, plotësinë dhe dendësinë u rregistruan në Figurat 19-21.

Cilësia e depërtimit të mbyllësit të kanaleve tubat dentinalë.

(%)Vazhdueshmëria

Figura

19

VAZHDUESHMËRA

A			B			C			D			E			F			G			
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	0	0	0	0	0	0	0
2	0	0	0	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	3	0	0	0	2	0	3	0
2	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	3	0	0	0
0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	0	0	0
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	0	2	0	0	0	3	0	3	0	0	0	0	3	0	0	3	3	0	3	0	0
2	3	2	0	0	0	3	0	3	0	0	0	0	3	0	0	3	0	0	0	0	0
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	3	0	0	0	3	3	0	0
1	0	2	0	0	0	3	3	3	0	0	0	0	3	0	3	3	0	1	3	3	3
1	0	3	0	0	0	3	0	3	0	0	0	0	1	0	3	0	3	3	3	0	0
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	0	0	0	0	0	0

Vazhdueshmëria

0= 90-100%

1= 50-90%

2=10-50%

3=0-10%

Figura 20. Cilësia e depërtimit të mbyllësit në tubat dentinalë(%) - Plotësia

PLOTËSIA

A			B			C			D			E			F			G		
0	0		0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	3	0	0	0	0	0		
2	0		0	0	0	0	3	0	0	0	2	2	0	0	0	0	1	2		
2	0		0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0		
0	0		0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		
0	0		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1		
0	0		2	0	0	3	3	0	3	0	0	0	0	3	0	0	0	0		
0	3		2	0	0	0	3	0	0	0	0	0	0	3	0	0	0	0		
0	0		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1		
0	0		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	3	0	0		
0	0		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2		
0	0		2	0	0	0	3	3	3	0	0	0	0	3	3	0	0	0		
0	0		0	0	0	0	3	0	0	0	1	2	0	3	0	0	0	0		
0	0		3	0	0	0	3	0	0	0	0	0	1	2	0	3	0	0		
0	0		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		

PLOTËSIA

0=90-100%

1=50-90%

2=10-50%

3=0-10%

Figura 21. Cilësia e depërtimit të mbyllësit në tubat dentinalë(%) Dendësia

DENDËSIA

A			B			C			D			E			F			G		
0 0	0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 1 1 0	2 0 0	0 0 1 0 0 0	2 0 0 1 0 0	0 0 1 0 0 0	0 0 1 0 0 0	0 0 1 0 0 0	0 0 1 0 0 0	0 0 1 0 0 0	0 0 1 0 0 0		
2 0	0 0 0	0 0 3 0 0 0	0 1 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 3 0	0 3 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 2 0 0 0 0	0 0 0 2 0 0	0 0 0 1 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0			
2 0	0 0 0	0 1 1 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	2 3	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 2 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0			
0 0	0 0 0	0 1 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 1 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0			
0 0	0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	1 0	0 0 0 0 0 0	1 0 1 0 1 1	1 0 1 0 1 1	1 0 0 0 0 0	1 0 0 0 0 0	1 0 0 0 0 0	1 0 0 0 0 0	1 0 0 0 0 0	1 0 0 0 0 0	1 0 0 0 0 0	2			
2 0	2 0 0	0 0 3 0 3 0	0 3 0 2 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	3 0	0 0 3 3 1	3 0 3 0 3 0	1 3 0 3 0 1	0 1 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0			
2 3	2 0 0	0 0 3 0 0 0	0 0 0 1 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	3 0	0 0 3 0 3	2 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0			
0 0	0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 2 1	0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 2 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 2			
1 3	0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 3 0 0	0 2 0 0 3 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	1 0			
0 0	2 0 0	0 0 3 3 3 0	0 3 3 1 2 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 3 3 3	3 0 3 3 3	3 0 3 3 3	3 0 0 0 0 0	2 1 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0			
0 0	3 0 0	0 0 3 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	3 0	0 3 3 2 3	0 3 3 3 3	0 3 3 3 3	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0			
0 0	0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 2 2	0 3 0 0 0	0 3 0 0 0	0 3 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 0	0 0 0 0 0 2			

DENDËSIA

0=90-100%

1=50-90%

2=10-50%

3=0-10%

III. Efekti i trajtimit me veshje të depërtimit të mbyllësit në kanalet dentinale.

Nuk ka diferencë ndërmjet grupeve EDTA dhe grupeve jo- EDTA (Mann Whitney U).

Për të dyja AH26 dhe MTA Fillapex nuk kishte diferencë ndërmjet grupeve EDTA dhe grupeve jo- EDTA (Mann Whitney U).

IV. Krahasimi i depërtimit të mbyllësve të ndryshëm.

AH26 tregoi depërtim më të mirë sesa MTA Fillapex (Mann-Whitney U)

V. Krahasimi i teknikave të mbushjes.

Rastet e mbushura me pika të ngrohta përmes degëve dhanë një rezultat më të mirë sesa rrënjet laterale kompakte. (Mann Whitney U).

VI. Krahasimi i të gjitha matjeve për të gjitha rastet.

Analiza e ndryshueshmërisë së rangjeve (Kruskal-Wallis) u përdor për të krahasuar më shumë se dy shembuj që janë të pavarur.

Figure 22. Të dhënata e rangjeve për matjet e mbushjeve.

	Grupi	N	Mesatarja e rangut
Mbushjet	A	600	1839,87
	B	520	2188,16
	C	600	2889,95
	D	430	1337,70
	E	470	1764,32
	F	530	1988,88
	G	600	2877,34
	H	490	1694,38
	Total	4240	

Test Statistikor(a,b)

	Monitorimi
Chi-Square	780,778
Df	7
Asymp. Sig.	,000

Për shkak të vlerës së $p=0.000 <\alpha=0,05$ kishte diferenca për secilin nga grupet dhe testi nuk identifikon diferençat që ndodhin, kështu që përdoret si shtesë testi [Mann–Whitney U](#), i cili u aplikua për të ndihmuar analizën e grup shembujve specifikë për diferençat sinjifikante.

Figura 23. Testi Mann-Whitney U për analizën e grup-shembujve për diferençat sinjifikante.

Krahasimi i grupeve		Vlera e p
A	B	0.000
	C	0.000
	D	0.000
	E	0.281
	F	0.064
	G	0.000
	H	0.103
B	C	0.000
	D	0.000
	E	0.000
	F	0.027
	G	0.000
	H	0.000
C	D	0.000
	E	0.000
	F	0.000
	G	0.620
	H	0.000

D	E	0.000
	F	0.000
	G	0.000
	H	0.000
E	F	0.025
	G	0.000
	H	0.496

Në bazë të të gjitha matjeve, për të gjitha grupet e marra nën konsideratë, nuk kishte diferencë ndërmjet grupeve A-E, A-F, A-H, C-G dhe E-H (testet Kruskal Wallis, Mann Whitney U).

Kishte diferencë ndërmjet grupeve A-B, C-D, E-F,G-H, A-G, B-E, B-F, B-G, B-H, C-E, C-F, C-H, D-E, D-F, D-G dhe D-H (Kruskal Wallis, Mann Whitney U).

